1.4.11

'ATRA E RINIS
**Revistë për Fëmijë**

Tiranë, me 21 Tetor 1937

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1 1/29-30

I ndershem e i dashur im Ungj;

Mora dje letren t'uaj dhe pergjigjem me një here, per te shpaguar vonesen e mëparshme, e cila nuk ardhi nga gjë tjeter, por vetem se kam patur shume skutura per vendosjen sidomos te femijve ne shkollat dhe, pastaj, nuk kisha gje te ngutshme per t'ju pergjegjur; te pakten keshtu mejtonja une.

Per katalogun (liste) e Libraris "Argus" nuk kujtonja se do t'a deshit me kaq nxitim, sa te aukohi per vonesen, me gjith qe per kete me shkruajte vetem ne letren e fundit. Po e nis sot me poste. Një shenim per librin "Αλβανικαί Μελέται" e gjeni ketu; me dhane per ato qe kane marre nga z. Turtulli; per ato qe kishin nga Seleniku nuk mund t'a japin tashi, se Drejtori vete i Libraris s'ndodhet ketu dhe shoku nuk e di ate hesap.

Per "Fletoren Zyrtare", kam kerkuar do nj'a 10 here gjer tashi, por thone qe kane shume pune dhe s'kane patur rast t'i kerkojne Numurat; sot do vete perseri. Per te Parlamentit ju shkrojta qe i kam gati, ato qe kishin te me japin.

Me duket, i nderuar Dhespot e Ungj i yne se nuk jam i pakujdeser, as i pertuar. Me gjith ate, ne gofte se ju kujtoni qe mund t'ju sjelle më teper sherbim tjeter-kush, beni si te deshironi. Une me gjith hallet e mia kam gajlene per Juve qe t'ju degjonj te nderuar dhe te kenaqur, qe te na nderoni edhe neve edhe vendin. Kejo osht ndjenja ime shpirtnore qe me shtyn t'interesohem per çeshtjet t'uaja, kudonse une kam nevoje per perkrahje e mbeshtetje.

Ne lidhje me kete kam t'ju them mjaft gjera qe kane te bejne me pozitun t'uaj, por s'mund te shpiegohem se largu. Nga keto, një gje qe s'pret kohe kam t'ju them: Degjova te thone, rrethet Korçare, se kini sjelle ose do te sillni një Kallogjer tjeter dhe kejo ka bere pershtypje jo te mire; me gjith qe kuptohet qellimi i juaj i kthjellte

ATRA E RINIS
**Revistë për Fëmijë**

Tiranë, me ........................

per te sjellë njerës q'e dinë punen që mund t'u ngarkohet për mirëvajtjen e punëve t'Administratës Kishtare, duan të thonë që vendi këtu ka njerës — klerikë — që vuajnë dhe duhen stervitur këta, në vend që të vijnë të huaj. Këto lutem t'i merrni para syshë se s'më pëlqen të dëgjonj pëshpëritje dhe këtë ua them nga mirëdashja e madhe që kam.

Pergjithësisht, për çështjen e Seminarit etj. mejtimi im është që të veproni më me durim e gjakftohtësi. Për shkollë të murgeshave kam informata që nuk do të hapen atje. Ju duhet t'a hapni Shkollën ne vndërtesë me qirà.

Me z. Naçi kam folur; është gjithënjë mirëdashës dhe ~~[illegible]~~ mburës i juaj. Ka ndër mend t'ju vizitojë këto dit.

Z. Papahristo ja njoftova fjalën t'uaj.

Për vajzën kuptonj se nuk u bë e nuk do bëhet gjë; bëmë keq që ua ngritmë mendjen... Për atë që thatë që t'a vinim në Internat, nuk më përmendni gjë në letrë; s'ju kanë lënë çështjet t'uaja, e kuptonj.

Me Z. Xh. Ypi s'jam parë akoma. Nga z. I. Kotta kini të fala.

Me shëndet jemi mirë të gjithë të shtëpis dhe ju puthim të djathtën e shenjtë ime-shoqe dhe fëmija. Me punën mirë vetë, lavdi Zotit.

Ju puth dorën
Nipi i juaj
Vasili

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1 Ι (30)

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ